




KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS Sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.



Rregulloren për Sponsorizime dhe Donacione

Shkurt 2024

Bazuar në kompetencat e përcaktuara në Rregulloret (By-Laws), Ligjin nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjit nr. 05/L-090 për Sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit (i plotësuar/ndryshuar me Ligjin nr. 06/L-116), Ligjin nr. 06/L-105 për Tatimin në të ardhurat e korporatave dhe Rregulloren nr. 01/2018 për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe formës për vërtetimin e sponsorizimit në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit-MKRS, Bordi i Drejtorëve të KEK SH.A. në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 29.02.2024 aprovoi:

**Rregulloren
Për Sponsorizime dhe Donacione**

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

**Neni 1
Qëllimi**

- 1.1 Kjo Rregullore për sponsorizime dhe donacione (në tekstin e mëtejshëm: Rregullore) ka për qëllim përcaktimin e procedurës, mënyrës dhe kriterëve për dhënien e sponsorizimeve dhe donacioneve nga Korporata Energjetike e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KEK sh.a).

**Neni 2
Barazia në trajtimin e rasteve**

- 2.1 Rregullorja për mbështetjen financiare dhe materiale për qëllime të sponsorizimeve dhe donacioneve bazohet në paanshmërinë, barazinë e veprimit si dhe parimet e etikës afariste, që do të thotë për të gjithë aplikantët zbatohet e njëjta procedurë, bazuar në kriterë objektive dhe profesionale të vendosura paraprakisht nga KEK sh.a.
- 2.2 Dhënia e fondeve për qëllime të sponsorizimeve dhe donacioneve bazohet gjithashtu edhe në të arriturat e aplikantit, që do të thotë se aplikantët duhet të justifikojnë kërkesën e tyre për fonde duke e dokumentuar përmes punës së tyre të mëparshme dhe rezultateve të arritura, si dhe angazhimit dhe objektivave të synuara përmes projektit / programit të propozuar.
- 2.3 Gjatë aktivitetit të dhënies së fondeve, zbatohet gjithashtu parimi i shmangies së konfliktit të interesit, e që nënkupton se individit që merr pjesë në vlerësimin e cilësisë së aplikacioneve të mos ketë interes material ose jo-material në çfarëdo rrethane.

Neni 3 Përkufizimet

- 3.1 Në këtë rregullore shprehjet e mëposhtme kane këto kuptime:
- 3.1.1 **Sponsorizim** - Mbështetje financiare dhe materiale në bazë të vullnetit të lirë të KEK sh.a. me qëllim të mbështetjes së aktiviteteve në fushën e rinisë, kulturës dhe sportit.
 - 3.1.2 **Promovim** - Vendosja dhe afirmimi i emrit, firmës dhe logos (emblemës) së dhënësit të sponsorizimit në mbështetje financiare të veprimtarive dhe aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive.
 - 3.1.3 **Reklama** - Promovim i logos në fanela, në objekte sportive, kulturore, rinore, në radiotelevizione, gazeta, revista, portale, afishe, tiketa, billborde dhe ueb faqe.
 - 3.1.4 **Donacion** - Mbështetje financiare apo materiale, për personat fizik dhe juridik në rast të emergjencave të shkaktuara si rezultat i forcës madhore, emergjencave të tjera ose ngjarjeve për qëllime mjedisore, si dhe mbështetje materiale për institucionet lokale dhe qendrore.
 - 3.1.5 **Aktivitetet** - veprimtaritë e ndryshme që mbështeten përmes sponsorizimit në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit.

Neni 4 Sponsorizimet

- 4.1 Me këtë rregullore do të sponsorizohen këto aktivitete:
- 4.1.1 Në fushën e kulturës përfshihen – ruajtja e trashëgimisë kulturore, ngjarjet artistike, kulturore, argëtuese, aktivitetet e qendrave kulturore, festivalet dhe mbështetjen e artistëve të merituar.
 - 4.1.2 Në fushën e rinisë përfshihen – aktivitetet e institucioneve edukative arsimore, punime shkencore universitare në fushën e sektorit energjetik, minerarë dhe digjitalizimit.
 - 4.1.3 Në fushën e sportit përfshihen – klubet sportive, federatat sportive dhe mbështetjen e sportistëve të dalluar.
 - 4.1.4 Aktivitetet me interes publik që përfshijnë por nuk kufizohen – konferenca shkencore dhe biznesore në sektorin energjetik dhe minerarë, konferenca me interes nacional.
- 4.2 Përveç aktiviteteve të parapara me nenin 4.1 më lartë, KEK do të kërkojë shërbime nga marrësi i sponsorizimit për KEK sh.a, si reklamimi ose promovimi në mënyra tjera i kompanisë KEK sh.a që do të kontribuon në njohjen dhe reputacionin e saj.

Neni 5 Donacionet

- 5.1 Me këtë Rregullore, mbështeten me donacion këto ngjarje:
- 5.1.1 Dëmet e shkaktuara si rezultat i forcës madhore apo emergjencave-ngjarjeve të cilat nuk kanë mundur të parashikohen.
 - 5.1.2 Mbështetje për qëllime mjedisore - iniciativa dhe aktivitete që kanë për qëllim mbrojtjen e mjedisit.
- 5.2 Aktivitetet e mësipërme do të bëhen në pajtim me Marrëveshjen mbi donacionin pa kërkuar ndonjë përfitim për KEK sh.a.

Neni 6 Burimet e financimit

- 6.1 KEK sh. a. do të ndajë fonde për sponsorizime dhe donacione deri në nivelin e shumës së planifikuar në Planin Vjetor të Buxhetit të KEK SH.A.
- 6.1.1 Fondet për donacione do të planifikohen në Planin Vjetor të Buxhetit të KEK sh. a. Vlera e përgjithshme e lejuar për kontribute të dhëna për interes publik nuk do të tejkaloj 1% të të ardhurave të tatueshme të llogaritura përpara se të jetë zbritur vlera për këtë kontribut¹.
 - 6.1.2 Ndërsa fondet për sponsorizime mund të jenë deri në limitin e lejuar sipas ligjit për sponsorizime Nr. 05/L-090, siç përcaktohet në nenin 17 të kësaj rregullore.

Neni 7 Format e sponsorizimeve dhe donacioneve

- 7.1 Me këtë Rregullore njihen këto forma dhe lloje të sponsorizimit dhe donacioneve:
- 7.1.1 Ofrimi i mjeteve financiare përmes xhironlogarisë bankare të pagesës së shumës totale të sponsorizimit apo donacionit.
 - 7.1.2 Ofrimi i punëve dhe shërbimeve nga KEK sh.a. dhe divizionet e saj për institucionet lokale dhe qendrore.
 - 7.1.3 Ofrimi i shërbimeve të rregullimit të ambientit dhe infrastrukturës së nevojshme për komunitet.

Neni 8 Publikimi dhe trajtimi i kërkesave

- 8.1 Rregullorja për sponsorizime dhe donacione, do të publikohet në ueb-faqen e KEK sh.a. në ditën e aprovimit.

¹ Referuar nenit 11.1 të Ligjit nr.06/105 për tatimin në të ardhurat e korporatave, dt.12.07.2019.

- 8.2 Sponsorizimet dhe donacionet do të trajtohen përgjatë vitit kalendarik në përputhje me fondet e dedikuara për sponsorizime dhe donacione, sipas nenit 6 më lartë.
- 8.3 Të gjitha vendimet e aprovuara për sponsorizime dhe donacione do të publikohen në ueb-faqen e KEK sh.a.

Neni 9

Forma e kërkesës dhe mënyra e aplikimit

- 9.1 Kërkesa për donacion duhet të përmbajë:
- a) të dhënat mbi aplikantin për dhënien e një donacioni / sponsorizimi: emri i kërkuarit, adresa, numri i llogarisë bankare, personi kontaktues, telefoni, e-mail adresa.
 - b) për persona juridik - certifikata e biznesit, certifikata nga regjistri i OJQ-ve, ID e personit të autorizuar, vërtetimin që dëshmon që subjekti nuk ka obligime tatimore, vërtetimin nga gjykata që subjekti nuk është në proces të falimentimit. Ndërsa për persona fizik duhet të dorëzohet kopja e ID, certifikata e shtetësisë, vërtetimi nga gjykata që dëshmon se personi fizik nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë për keqpërdorim, vërtetimi nga autoriteti i asistencës sociale (në rastet e mbështetjes përmes donacioneve).
 - c) deklaratë nën betim se kërkuari nuk ka qëllime politike dhe se nuk ka konflikt interesi në kërkesën e tij për fonde.
 - d) dëshminë e regjistrimit nëpër organizatat, institucionet përkatëse për kulturë, rini dhe sport në nivel lokal apo qendror (për kërkesat e sponsorizimeve).
 - e) përshkrimi i qëllimit të dhënies së donacionit / sponsorizimit: emërtimi, qëllimi, kohëzgjatja, vendi i realizimit të projektit, si dhe një përshkrim të shkurtër mbi objektivat e projektit.
 - f) kategoria për të cilën kërkohet donacion ose sponsorizim: sport, shëndetësi, shkencë, arsim, kulturë dhe art, aktivitete botuese, mbrojtje mjedisore, e tjera.
 - g) statusi i aplikantit: person fizik dhe juridik, institucion, shoqatë jo fitimprurëse, federatë sportive;
 - h) shuma e kërkuar për donacion ose sponsorizim, dhe linjat buxhetore të ndara për secilin shpenzim
- 9.2 Parashtruesi i kërkesës dorëzon kërkesën në formë fizike në arkivin e KEK SH.A.
- a) Kërkesat i pranon Komisioni për Sponsorizime dhe Donacione prej tre anëtarëve , të caktuar me vendim të Kryeshefit Ekzekutiv. Mandati i anëtarëve të Komisionit do të jetë tre (3) vjeçar.
 - b) Komisioni do të mbajë një evidencë të veçantë për kërkesat e pranuar dhe vendimet për secilën kërkesë individuale.
 - c) Përmbajtja e detyrueshme e evidencës është: numri i kërkesës, data e pranimi, emri i aplikantit, lloji i kërkesës (sponsorizim ose donacion) dhe rezultati i përzgjedhjes.

- d) Arkivimi i dosjeve të kërkesave për sponsorizime dhe donacione do të bëhet në Departamentin për Marrëdhënie me Publikun.
- e) Komisioni vendos për kërkesat e pranuar çdo tre muaj, të paktën një herë gjatë një tremujori, derisa të shpenzohen fondet në dispozicion. Në rast të ndonjë kërkesë specifike me interes të përgjithshëm publik, kërkesa mund të shqyrtohet në një afat kohor më të shkurtër, megjithatë miratimi mbetet në diskrecion të Bordit të Drejtorëve pas propozimit të menaxhmentit.
- f) Në rastin e shpenzimit të të gjitha fondeve në dispozicion, Komisioni do të publikoj njoftimin në uebfaqe të KEK, se mjetet e buxhetuara për vitin kalendarik janë shpenzuar dhe kërkesat për donacione / sponsorizime nuk do të trajtohen gjatë këtij viti.

Neni 10 Kriteret

- 10.1 Gjatë vlerësimit të projekteve/programeve të pranuar nga shoqëritë, organizatat dhe personat të tjerë fizikë apo juridikë do të zbatohen kriteret e përgjithshme si me poshtë:
- a) cilësia e propozimit të projektit / programit,
 - b) cilësimi i projektit / programit me interes të përbashkët shoqëror ose publik,
 - c) kontributi në afirmimin e vlerave individuale dhe të përgjithshme të bashkësisë shoqërore, siç është humanizmi, etika, aspekti shoqëror, të drejtat e njeriut, etj.
 - d) të kenë përmbushur në vazhdimësi detyrimet nga të gjitha marrëveshjet e sponsorizimit të lidhura më parë,
 - e) vlera e projekteve dhe programeve paraprake të realizuara,
 - f) të ketë kapacitetet e duhura organizative dhe njerëzore për implementim të projektit / programit të propozuar.
 - g) personat fizik dhe juridik të cilët kërkojnë sponsorizim nga KEK në fushën e rinisë, sportit dhe kulturës, duhet të plotësojnë kriteret e veçanta sipas neneve 4, 5 dhe 6 të Rregullores nr.01/2018 për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe formës për vërtetimin e sponsorizimit në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit-MKRS.
 - h) Për sponsorizime në fushën e shkencës (punime/publikime shkencore, botime, etj) personi fizik duhet të paraqes pëlqimin e institucionit arsimorë/shkencorë/shoqatë se kërkesa e parashtruar është me interes publik.

Neni 11 Shqyrtimi dhe aprovimi

- 11.1 Vendimi për aprovimin e kërkesave për sponsorizime dhe donacione merret nga Kryeshefi Ekzekutiv bazuar në vlerësimin dhe propozimet e Komisionit për Sponsorizim dhe Donacione dhe bazuar në mundësitë financiare të KEK sh.a, sipas shumës së planifikuar për Sponsorizime dhe Donacione në Planin Vjetor të Buxhetit të KEK SH.A.

Kryeshefi Ekzekutiv mund të aprovoj kërkesat deri në 8,000.00 (€), dhe në çdo tre mujorë të raportoj te Bordi i Drejtorëve për të gjitha kërkesat, ndërsa, kërkesat mbi këtë vlerë do të shqyrtohen nga Bordi i Drejtorëve të KEK SH.A.

- 11.2 Komisioni mund t'i propozojë Kryeshefit Ekzekutiv pranimin e kërkesës për sponsorizim/donacion plotësisht ose të pjesshme.
- 11.3 Në rast të mosmiratimit të kërkesës për sponsorizim ose donacion, KEK sh.a informon parashtruesin e kërkesës lidhur me vendimin, pa qenë i obliguar të arsyetojë refuzimin e kërkesës.

Neni 12

Rastet e shkaktuara nga forca madhore dhe emergjencat e jashtëzakonshme

- 12.1 Në rast të emergjencave nga forca madhore natyrore ose emergjencave të tjera ose ngjarjeve që nuk kanë mundur të parashikohen, Kryeshefi Ekzekutiv në përputhje me kompetencat mund të vendosë fonde për donacione pavarësisht nga dispozitat e kësaj Rregulloreje, pas aprovimit të Bordit të Drejtorëve.
- 12.2 Donacionet e miratuara sipas këtij neni nuk ngarkojnë shumën e planifikuar vjetore për donacione dhe sponsorizim.

Neni 13

Procedura pas aprovimit

- 13.1 Nëse KEK sh.a miraton kërkesën për sponsorizim do të lidhet Marrëveshje për sponsorizim me marrësin e fondeve.
- 13.2 Në Marrëveshjen e Sponsorizimit, KEK sh.a do të përcaktojë në mënyrë më të detajuar me marrësin e sponsorizimit të drejtat dhe detyrimet reciproke, veçanërisht në lidhje me zbatimin e aktiviteteve promovuese për të cilat KEK c është e interesuar.
- 13.3 Pavarësisht kërkesave të mësipërme të këtij neni, në rastet kur KEK sh.a miraton kërkesën për donacion duhet lidhur Marrëveshje të veçantë me marrësin e fondeve.

Neni 14

Pagesa dhe ofrimi i shërbimeve

- 14.1 Vendimet për sponsorizimet dhe donacionet me mjete financiare zbatohen nga Departamenti i Financave dhe Kontabilitetit duke paguar shumën e miratuar në llogarinë bankare të marrësit. Në rastin e sponsorizimit pagesa bëhet në llogari bankare të marrësit në shumën e rënë dakord sipas Marrëveshjes.
- 14.2 Vendimet për sponsorizim dhe donacione në formë materiale (ofrimi i shërbimeve) zbatohen nga divizionet përkatëse të KEK sh.a.

Neni 15 **Raportimi**

- 15.1 Palët që kanë marrë sponsorizim i detyrohen KEK sh.a në pajtim me marrëveshjen të raportojnë mbi aktivitetet e mbajtura, dhe të dokumentojnë qartë se detyrimet janë kryer plotësisht, në bazë të marrëveshjes për sponsorizimit e caktuar, dhe pranuesi obligohet të dorëzojë raportin përfundimtar mbi shpenzimet e sponsorizimit.
- 15.2 KEK do të kërkoj nga përfituesit e sponsorizimit (në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit), të paraqesin Vërtetimin për përcaktimin e interesit publik, i cili lëshohet nga Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për sponsorizim në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit².

Neni 16 **Kontrolli i shfrytëzimit të sponsorizimit dhe donacionit**

- 16.1 Në qoftë se gjatë kontrollit vërtetohet ndonjë pa rregullsi, shkelje e kritereve të kësaj rregulloreje apo keqpërdorime gjatë shfrytëzimit të sponsorizimit apo donacionit, KEK sh.a rezervon të drejtën në çdo kohë të ndërpres akordimin e aktiviteteve të sponsorizimit dhe fondeve për donacione dhe të kërkojë kthimin e mjeteve. Po ashtu, KEK do të ushtroj edhe kallëzim penal në rastet kur vërehet keqpërdorimi/parregullsia.
- 16.2 Në rastet e donacioneve, pranuesi paraprakisht duhet të nënshkruaj një deklaratë, duke konfirmuar se mjetet e pranuar do t'i përdor vetëm për qëllimin për të cilin ka aplikuar.

Neni 17 **Zbritjet e lejuara për qëllime tatimore**

- 17.1 Në fund të vitit fiskal, KEK sh.a do të ketë të drejtën e zbritjes nga obligimi i pagesës së tatimit në fitim deri në 30% për aktivitetet e sponsorizuara në fushën e sportit dhe deri në 20% për aktivitetet e sponsorizuara në fushën e kulturës dhe rinisë³.

Neni 18 **Përjashtimet**

- 18.1 KEK sh.a. nuk do të sponsorizon apo jep donacion për kategoritë si në vijim:
- a) Partitë politike, përfaqësues të pavarur, personat e ekspozuar politikisht dhe gjitha format e organizimeve partiake të çfarëdo niveli.

² Siç përcaktohet në Rregulloren nr.01/2018 për përcaktimin e kritereve, procedurave dhe formës për vërtetimin e sponsorizimit në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit-MKRS të datës: 23/01/2018, neni 11, paragrafi 1.

³ Neni 11, paragrafi 1.1 i Ligjit nr.06/L-105 për tatimin në të ardhurat e korporatave dhe Neni 12, paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit nr.05/L-090 për Sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit.

- b) Organizatave apo individit, aktiviteti i të cilave nuk është në pajtim me vlerat që promovon kompania, e që është i ndaluar me kushtetutë dhe ligje të Republikës së Kosovës.
- c) Organizatave që kanë borxh ndaj kompanisë apo obligime të pa shlyera ndaj KEK sh.a si dhe institucioneve shtetërore (Administratës Tatimore të Kosovës).
- d) Organizatat anëtarët e saj me veprimet e deri tanishme i kanë sjellë dëm në reputacion apo i kanë sjellë dëme materiale KEK sh.a.
- e) Organizatave apo aktiviteteve të cilat kanë mundësi të dëmtojnë reputacionin e KEK sh.a apo interesin biznesor të saj.
- f) Organizatave apo individit i cili ka selinë jashtë territorit të Republikës së Kosovës.

Neni 19
Dispozitat përfundimtare

Më së voni deri në fund të shkurtit, KEK sh.a do të publikojë në faqen e saj të internetit emrat e pranuesve dhe shumat e fondeve të dhëna për sponsorizim dhe donacione për vitin e kaluar fiskal.

Neni 20

Kjo Rregullore do të hyjë në fuqi në ditën e miratimit të saj.

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve të KEK –Sh.A
z. Arton Ahmeti



Prishtinë, datë 29 Shkurt 2024

